ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**632-24-1656-1-2-1**
Nr i brendshëm	**632-24-017-121**

Sa i përket tenderit për: **FURNIZIM ME PELET.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Ntp Gresa Commerc

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Piranë,

(Adresa)

Prizren ***20000***

(Vendi) ***(Kodi postar)***

044 121 152

(Numri Telefonit) ***(Numri i Faks-it)***

Sahit Bajrami

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ntpgc1@hotmail.com

(Adresa elektronike)

19.06.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) ***(Nënshkrimi dhe vula)***

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 28.02.2024 Hapja e ofertave: 21.03.2024 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 25.04.2024 Kërkesa për rishqyrtim: 30.04.2024 Vendimi për aprovimin e pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim: 03.05.2024 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 31.05.2024 Kërkesa për rishqyrtim me dt:05.06.2024 Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.10.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fillimisht ju sqarojmë se ne me dt.25.04.2024 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë OE "**DHF Company SH.P.K.**, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Ju si Operator Ekonomik nuk keni ofruara dëshmi se keni përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit ne në vlere prej 180,000.00€, mungojnë librezat e qarkullimit për paisjet si dhe mungojnë kontratat e punetoreve.

Ne kundër këtij vendimi kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.30.04.2024, ndërsa autoriteti kontraktues me dt.03.05.2024, na ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim dhe e ka kthyer lëndën në rivlerësim.
Tani pas rivlerësimit me dt.31.05.2024 e njëjta ka publikuar përsëri njoftimin mbi vendimin e saj, ku përsëri e ka rekomanduar për kontratë OE "**DHF Company SH.P.K.**, ndërsa përsëri neve na ka eliminuar me arsyetimin e njëjtë.

Sa i përket arsyes së eliminimit tonë, ne edhe një herë po e sqarojmë se autoriteti kontraktues nuk ka përdor standarde të njëjta gjatë vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave, pasi që ka kërkuar sqarime për OE e rekomanduar për kontratë, ndërsa për neve nuk ka kërkuar sqarime fare për referencat, pajisjet dhe kontratat e punëtorëve. Sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është e abstrakte dhe e përgjithësuar, ndërsa ne kemi ofruar listën e pajisjeve dhe listën e punëtorëve, prandaj në këtë rast është dashur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues edhe me rastin e rivlerësimit të ofertave na ka diskriminuar, pasi që OE të rekomanduar për kontratë i ka kërkuar sqarime shtesë, ndërsa neve nuk na ka kërkuar sqarime fare, duke e shfaqur edhe një herë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë.

Ne përmes kësaj kërkese për rishqyrtim edhe një herë po e sqarojmë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, përkatësisht kërkesën "*Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 180.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme*", ku si dëshmi dokumentare për këtë kërkesë është kërkuar *"Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve"*.

OE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, për faktin se në ofertë ka prezantuar një listë të furnizimeve të realizuara të gjitha me kompani private dhe të njëjtave ju figuron titulli furnizim me lëndë djegëse.
Kur analizohen dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë të dorëzuara me ofertë askund nuk figuron ndonjë dokument si referencat apo raportet e pranimit të furnizimeve.

Gjithashtu përveç faktit që i njëjti nuk ka prezantuar referencat, edhe projektet të prezantuara në listë nuk mund dhe nuk duhet ti merren parasysh pasi që të njëjtat nuk janë të natyrës së kontratave apo të ngjashme, por të njëjtat kontrata kanë të bëjnë me furnizim me karburante.

Autoriteti kontraktues me dt.12.04.2024 kishte kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë si në vijim:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

- Operatori Ekonomik duhet të ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme me 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate). Ne një vlere jo me pak se 180.000,00, në rast konsorciumi lideri duhet te ketë të paktën 60% kontrata te natyrës se ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Lista e kontratave te realizuara ne 3 (tre) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve.

SQARIM:

Kërkojmë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së për:

-Ju si Operatorëve Ekonomik nuk keni prezentuar dëshmi kontrata dhe referenca per kryerje te furnizimeve.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen përmes platformës se prokurimit elektronik deri me dt.**16.04.2024**

OE i rekomanduar për kontratë është përgjigjur duke ofruar kontratat dhe referencat me kompani private, por për të cilat nuk është ofruar asnjë transaksion bankar për të vërtetuar në mënyrë objektive se këto kontrata janë realizuar, prandaj këto kontrata dhe referenca nuk duhet të merren parasysh dhe nuk janë valide derisa nuk dëshmohen me transaksione bankare.

Mirëpo edhe nëse do të ishin prezantuar transaksionet bankare, përsëri kontratat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk mund të merren parasysh për shkak që nuk janë të natyrës së kontratës apo të ngjashme.
Edhe me sqarimet që janë ofruar, për disa kontrata nuk dihet objekti i kontratës cili është, pra nuk dihet se për çfarë furnizime janë lidh këto kontrata .p.sh kontrata e prezantuar me "Ndërtimi NTP Xun Qorraj B.I, me "Ahmetaj Group SHPK", me "Shefqet NTSH SHPK".
Pra, në këto kontrata shkruan se janë lidh për lëndë djegëse, ndërsa nuk specifikohet saktë se cila është lënda djegëse, po ashtu edhe në disa prej referencave nuk ceket saktë çfarë furnizimi ka qenë.
Andaj kërkojmë që të analizohet në tërësi pretendimi ynë ankimor dhe dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, pasi që siç e cekëm ky OE është i papërgjegjshëm.
Dyshojmë se kontratat dhe referencat janë fiktive dhe nuk janë realizuar asnjëherë, prandaj kërkojmë që të verifikohen dhe të kërkohen transaksionet bankare në lidhje me këto kontrata dhe referenca.

Ne nga qasja në dokumente që kemi pasur, e kemi parë që OE të rekomanduar për kontratë, i janë kërkuar sqarime me dt.15.05.2024 dhe përsëri me dt.23.05.2024, ku nga këto sqarime kuptohet qartë se autoriteti kontraktues me qëllimin e vetëm që ta rekomandoj të njëjtin për kontratë, është munduar në çdo mënyrë të shpall të përgjegjshëm këtë operator ekonomik.
Edhe pse të njëjtin i janë kërkuar sqarime dy herë radhazi, ky OE përsëri nuk ka mundur të jep dëshmitë e kërkuara, mirëpo edhe përkundër këtij fakti autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë. Në kërkesën për sqarime të dt.23.05.2024 janë kërkuar që të prezantohen faturat që përputhen me transaksionet e prezantuara, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë në asnjërën prej përgjigjjeve nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi që transaksionet e prezantuara kanë të bëjnë me furnizim me pelet. Gjithashtu edhe faturat e lëshuara nuk mund dhe nuk duhet ti merren parasysh fare.

Kur analizohen dëshmitë të cilat i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë shihet qartë se i njëjti nuk ka prezantuar dëshmi konkrete nga banka, mirëpo i ka përgatitur vet disa dokumente me emër kartelë financiare të cilat mbajnë vulën e OE të rekomanduar për kontratë dhe jo të bankës, andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon dëshmi që ka përfunduar kontrata të natyrës së kontratës apo të ngjashme dhe si i tillë në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu të gjithë OE të tjerë ashtu siç e ka vërtetuar edhe autoriteti kontraktues janë të papërgjegjshëm si në vijim:

OE N.T.SH. BEDI COM është i papërgjegjshëm për faktin se:

- Ju si Operator Ekonomik keni gabuar ne llogaritje. Çmimi i lexuar në hapje është 88.600,00€, kurse çmimi i llogaritur është 90.364,00€

Grup i OE KIGA SH.P.K.; LIKI GROUP SH.P.K.,, është i papërgjegjshëm për faktin se:

- Ju si Grup i Operatorëve Ekonomik nuk keni prezentuar qarkullim financiar me nje vlere te përgjithshme prej 240.000,00€. Nuk keni prezentuar kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit ne vlere prej 180.000, 00€, mungojnë kontratat e punetoreve, gjysem rimorkio 01-616-TA nuk ka regjistrim.edhe kamion 2 dyer me regjistrim 01-108-OS eshte i pa regjistruar.

OE Avni Murtezi B.I., është i papërgjegjshëm për faktin se:

- Ju si Operator Ekonomik nuk keni prezentuar qarkullim financiar ne vlere prej 240.000,00€, nuk keni prezentuar libreza te qarkullimit për paisjet 01-861-UB dhe 01-219-ZE , si dhe mungojnë kontratat e punëtorëve.

OE Geo Group, është i papërgjegjshëm për faktin se:

- Ju si Operator Ekonomik nuk keni prezentuar sigurim te tenderit.

OE N.P.T. Burimi, është i papërgjegjshëm për faktin se:

- Ju si Operator Ekonomik nuk keni prezentuar libreza te qarkullimit per paisjet 01-861-UB dhe 01-219-ZE .

OE IB Trading SH.P.K., është i papërgjegjshëm për faktin se:

Ju si Operator Ekonomik nuk keni ofruara dëshmi se keni përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit ne në vlere prej 180,000.00€ si dhe mungojnë librezat e qarkullimit për paisjet.

OE N.T.SH. Nazi Travel, është i papërgjegjshëm për faktin se:

Ju si Operator Ekonomik nuk keni prezentuar qarkullim financiar ne vlere prej 240.000,00€, nuk keni ofruara dëshmi se keni përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit ne në vlere prej 180,000.00€ mungojnë paisjet si dhe mungojnë kontratat e punëtorëve.

Grupi i OE Petrol Company SH.P.K. & Bek Fluids L.L.C., është i papërgjegjshëm për faktin se:

Operator Ekonomik Bek Fluids nuk ka prezentuar certifikate te TVSH-se.
- Ju si Grup Operator Ekonomik nuk keni ofruara dëshmi se keni përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit ne në vlere prej 180,000.00€.

OE **Aome** është i papërgjegjshëm, sepse nuk ka ofruar listën e kontratave sipas aneksit 7 që ka qenë obligativ dhe listën e pajisjeve sipas kërkesës së dosjes së tenderit.
NTP Haxha është i papërgjegjshëm me arsyen si më poshtë:

- Ju si Operator Ekonomik nuk keni ofruara dëshmi se keni përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit ne në vlere prej 180,000.00€, mungojnë dëshmitë për paisjet si dhe mungojnë kontratat e punëtorëve.

Pra të gjitha arsyet e eliminimit të cekuar nga AK-së janë edhe pretendime tona ankimore.

Ne me dt.10.06.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja është arsyetuar se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk është dhënë asnjë arsyetim konkret për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim në lidhje me arsyen e eliminimit tonë ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues është dashur të ju kërkoj sqarime në bazë të nenit 72 të LPP-së, nuk qëndron , sepse ju nuk keni prezentuar kontratat e punëtorëve, të cilat janë dokument të cilat mund të prodhohen dhe vërtetësia e tyre nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive , prandaj nuk ju janë kërkuar sqarime në bazë të nenit 72 të LPP-së as për pikat tjera.
Në bazë të nenit 72 të LPP-së, mund të kërkohen vetëm dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Arsyetimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm dhe për më tepër tendencioz, për faktin se ne në ofertë e kemi bashkangjitur listën e punëtorëve, mirëpo që ka ndodhur një lëshim teknik gjatë ofertimit ku nuk janë bashkangjitur kontratat e tyre. Andaj autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë përderisa figurojnë emrat e punëtorëve në listë dhe kontratat do ti kishim prezantuar për punëtorët të cilëve ju figuron emri në listën e dorëzuar.
E njëjta me një arsyetim të tillë është munduar të i ik përgjegjësisë dhe shkeljeve që ka bërë gjatë rivlerësimit të tenderëve.
Ne në listë të stafit i kemi prezantuar punëtorët, ku katër prej tyre i kemi të deklaruar edhe në ATK dhe për këtë mund të ju prezantojmë edhe dëshmitë, ndërsa me dy punëtorët e tjerë kemi të lidhur marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt. Në momentin që ne i kemi prezantuar punëtorët kuptohet se me ta kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi, pasi që nuk mund të vendosim në listë emra të punëtorëve me të cilët nuk kemi të lidhur marrëveshje bashkëpunimi paraprakisht.

Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që nuk na ka kërkuar sqarime shtesë, ndërsa ka përdorur standarde të dyfishta ku OE të rekomanduar për kontratë i ka kërkuar dy herë rresht sqarime, ndërsa neve nuk ka shprehur fare interes për të na kërkuar sqarime.

Ndërsa në lidhje me pretendimin tonë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Pretendimi juaj se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nuk qëndron , sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar dy kontrata për furnizim me pelet me operator privat të cilat mbulojnë kërkesat në FDT-së, dhe për të cilat Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime – fatura dhe transakcione bankare në bazë të nenit 72 të LPP-së, të cilat ky operator i ka prezantuar duke plotësuar kështu kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

Arsyetimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se dëshmitë e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e qartësojnë gjendjen faktike. Dëshmia e pagesës e prezantuar ku

figuron emri i kompanisë Eskavatori SHPK dhe nga kompania Ahmetaj Group SH.P.K., askund nuk shënon që këto transaksione apo dëshmi janë për furnizim me pelet.
Gjithashtu edhe faturat e lëshuara nuk mund dhe nuk duhet ti merren parasysh fare.

Veprimi i autoritetit kontraktues ku e ka rekomanduar për kontratë përsëri këtë OE është veprim favorizues, ku edhe pse nuk janë ofruar dëshmi konkrete përsëri është rekomanduar për kontratë ky operator ekonomik.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura autoriteti kontraktues është dashur të analizoj në tërësi dëshmitë e prezantuara nga ana e OE të rekomanduar dhe pas analizës të konstatoj se asnjëra nga dëshmitë e prezantuara nuk e vërteton faktin se i njëjti OE ka përfunduar furnizime me pelet. Pra vendimi i autoritetit kontraktues është i pa bazuar, andaj kërkojmë nga ana e OSHP-së dhe ekspertit shqyrtues që të analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore dhe të nxjerret një vendim meritor, në lidhje me këtë qështje.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.
Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "*Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që është rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të lëshojë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **N.T.P. " Gresa – Commerc"** si dhe të
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**
dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*